

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË INSTITUTIN E KUJDESIT SHËNDETËSOR, TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në **ISKSH Tiranë**, me objekt: “*Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë ekonomiko financiare dhe vlerësues, për periudhën 1/1/2011 deri më 31/12/2011*” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 118, datë 30/07/2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 448/5, datë 30/07/2012 dërguar **Zj. Elvana Hana, Drejtore e ISKSH Tiranë**, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 10296, datë 8/7/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, në kundërshtim me nenin 27 të këtij ligji, nga ISKSH gjatë vitit 2011, nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik të riskut, i cili sipas pohimeve të institucionit vepron në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë.

- ISKSH, në kundërshtim me nenin 21 të këtij ligji, nuk ka të formalizuar dhe dokumentuar ndonjë procedurë për menaxhimin e riskut, për identifikimin, analizimin dhe kontrollin e risqeve që mund të vënë në rrezik përmbushjen e objektivave të institucionit, të përcaktuara gjatë planifikimit afatmesëm dhe vjetor. Për këtë, **rekomandojmë që:**

a) Nga ISKSH, të merren masa që të krijohet dhe të vihet në funksionim Grupi i Menaxhimit Strategjik, kjo të jetë vetëm për ISKSH duke përmbushur të gjitha detyrimet që i ngarkohen në zbatim të ligjit.

b) Të merren masa e të përfundojë puna për “Hartimin e strategjisë së menaxhimit të riskut në ISKSH”, me qëllim vlerësimin dhe identifikimin e risqeve, si përparësi në lidhje me objektivat e përcaktuara në buxhetimin afatmesëm dhe mbrojtjen e institucionit nga risqet që mund të krijohen dhe që pengojnë realizimin e objektivave të ISKSH.

Brenda muajit Shtator 2012

2. Nga auditimi i ushtruar u konstatua se disa nga rekomandimet e lënë nga auditimi i mëparshëm nuk janë realizuar plotësisht dhe disa janë në proces realizimi. Për këtë, **rekomandojmë që:**

- Të merren masa dhe të organizohet puna duke analizuar e nxjerrë shkaqet dhe përgjegjësitë e mosrealizimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, si dhe të programohet puna për realizimin e tyre sipas afatit të përcaktuar.

Brenda muajit Gusht 2012

3. Në auditimin e kryer në fazën e hartimit të Projektbuxhetit të vitit 2011, në përlogaritjen e zërit të buxhetit “Financimi i shërbimit spitalor”, nuk është përmbushur detyrimi i VKM nr.140, datë 17.2.2010, që detyron spitalet dhe ISKSH-në të llogarisin koston e çdo shërbimi në përputhje me standardet e Ministrisë së Shëndetësisë brenda 6-mujorit të parë të vitit 2010. Si rezultat i kësaj është mbajtur për referencë buxheti historik i spitaleve dhe një rritje 3% në krahasim me vitin 2010, pa parashikuar rritje të numrit të punonjësve dhe duke marrë parasysh një rritje minimale pagash, duke filluar nga 6/mujori i dyte i vitit 2011. Me daljen e VKM nr. Nr.15, datë 11.01.2012, llogaritja e kostove faktike bëhet nga spitalet. Për këtë, **rekomandojmë që:**

- ISKSH, të marrë masat që në bashkëpunim me spitalet dhe me Ministrinë e Shëndetësisë, të përmbushë detyrimin e saj për monitorimin e llogaritjeve dhe përcaktimin e kostove faktike të çdo shërbimi në spitale, duke rritur ekonomikitetin, efektivitetin dhe eficientën e fondeve të dhëna për spitalet, brenda vitit ushtrimor dhe përafrimin e treguesve buxhetor për plotësimin e standardeve të shërbimit spitalor.

Vazhdimisht në vitin 2012-2013

4. Nga auditimi i aktiviteteve për pritje përcjellje të organizuara në institucion për vitin 2011, u konstatua se kuotat e përdorura, si për vlerën dhe numrin e pjesëmarrësve janë kryer pa miratimin e titullarit të institucionit, *(por me shkresë të asistentes)*, pra jo siç e kërkon VKM nr. 243, datë 15/6/1995 “Për pritje e përcjellje”, i ndryshuar. Për këtë, **rekomandojmë që:**

- Të merren masa dhe të ndiqen procedurat ligjore për organizimin e pritje përcjelljeve, gjithashtu miratimi i numrit të pjesëmarrësve të bëhet nga titullari i institucionit, kjo të bëhet për çdo organizim.

Vazhdimisht

5. Në auditimin e kryer në vlerësimin e përmbajtjes së kontratave F/2011,D/2011 dhe A/2011, është konstatuar se në disa nene të kontratës kryesisht për të drejtat dhe detyrimet ekonomike të kontraktorëve, rezultojnë se janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, kryesisht me legjislacionin tatimor dhe ligjin “Për kontabilitetin”. Për mos zbatimin e kriteve dhe kushteve të kontratës në disa prej tyre nuk ka sanksione (penalitetet) ose janë të lehta dhe të pa argumentueshme në ato vlera, kjo sjell një risk në vijimësi të ISKSH, ndërkohë që kontraktori ndihet “komod” edhe kur nuk përmbush kushtet e kontratës, pasi penalteti i vendosur nuk sjell shqetësim dhe nuk imponon respektin e barabartë të partneritetit mes palëve.

Për këtë, **rekomandojmë që:**

- Nga ISKSH të ngrihet grup pune në bashkëpunim me grupet e interesit (farmacistë e grosistë), ku në përbërje të tij të ketë dhe specialistë finance dhe juristë e të rishikohet kontrata tip, kryesisht në drejtim të trajtimit ekonomiko financiar dhe përgjegjësisë ligjore për moszbatim të saj (vendosje penaliteti dhe masa të tjera), duke e shqyrtuar në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Brenda muajit Shtator 2012

6. Nga auditimi i kryer u konstatua se nuk ka gjetur zbatim të plotë V.K.M nr.140 datë 17.02.2010, në zbatimin e standardeve të përcaktuara për shërbimin spitalor, pasi nga Ministria e Shëndetësisë nuk janë nxjerrë akoma Standardet e përcaktuara dhe nuk janë rivlerësuar.

Për këtë, **rekomandojmë që:**

- Nga ISKSH, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë (Drejtorinë e Përgjithshme të Politikave dhe Drejtorinë Spitalore), të kërkohet e të përgatiten Standardet e përcaktuara së bashku me kostot faktike, të cilat do të shërbejnë si bazë për hartimin e kostove të paketave të shërbimeve, të cilat aktualisht janë në proces përgatitje për zbatimin e ligjit nr.10383 datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, më pas do të miratohen nga Këshilli i Ministrave dhe hyjë në fuqi në muajin Mars 2013.

Brenda muajit Nëntor 2012

7. Nga ISKSH dhe Drejtoria e Auditimit të Brendshëm (DAB), të rishikohet plani vjetor, të bëhet shpërndarje më racionale e specialistëve të auditimit dhe të shikohet mundësia e përcaktimit të objekteve me risk të lartë. Në këtë proces të përfshihen detyrimisht specialistët me përvojë dhe të shmangët shtimi i personave të panevojshëm.

Brenda vitit 2012

8. Nga auditimi i ushtruar u konstatua se në auditimet e kryera, konstatohen kontrole të përsëritura në veprimtarinë kontrolluese të DAB me Drejtorinë e Kontrollit Parësor e Farmaceutik në DRSKSH-të, veçanërisht në kontrollet financiar të veprimtarive farmaceutike, duke kryer auditim për të njëjtin problem dy herë dhe në disa raste janë dhënë konkluzione të ndryshme.

Për këtë, **rekomandojmë që:**

- Të bashkërendohet puna nga ISKSH me DAB dhe D.K.P.F, për të shmangur kryerjen e kontrolleve në të njëjtin objekt (DRSKSH-të), e harxhuar burime njerëzore të panevojshme.

Menjëherë

9. Të organizohen trajnime për sektorët e kontrollit në DRSKSH-të në rrethe, duke bërë përgjithësimet e atyre kontrolleve që kanë rezultuar me rezultate e tregues

pozitivë, si dhe ekspozimin e shkeljeve dhe mangësive të kontestuara, me qëllim mos përsëritjen në të ardhmen.

Vazhdimisht

10. Duke patur parasysh administrimin dhe qarkullimin e vlerave të konsiderueshme financiare, si dhe specifikat e financimit të vlerave të rimbursueshme. ISKSH, të ngrejë një bërthamë me specialistë për të gjetur mënyrat dhe përsosur metodat e auditimit financiar, kontrollit farmaceutik dhe atij spitalor, duke hartuar dhe nxjerrë udhëzime sa më profesionale, madje të punohet për një manual kontrolli farmaceutik e spitalor. Kjo realizohet duke bashkëpunuar dhe asistuar nga institucione të specializuara të Auditimit dhe Kontrollit financiar, brenda dhe jashtë vendit.

Brenda muajit Tetor 2012

11. Në hartimin e programeve të auditimit nga DAB, të studiohen dhe vlerësohen subjektet me risk të lartë, ndërsa për subjektet që nuk qarkullojnë vlera të mëdha financiare, të programohen e të kryhen auditime tematike për objekte të veçanta dhe rezultatet të përgjithësohen, çka do të rrisë efikasitetin dhe performancën e DAB, si dhe do shmangë harxhimin e burimeve njerëzore pa efektivitet.

Vazhdimisht

12. Të merren masa dhe të shfrytëzohen të gjitha mundësitë për të shmangur pagesat e listës së recetave të rimbursuara, ku shkruhet emërtimi "i panjohur" nga sistemi dhe të ndalohen pagesat e rimbursimeve pa u identifikuar personat konkretë. Kjo të jetë objekt vlerësimi e kontrolli, si nga strukturat e DRSKSH-ve në rrethe dhe nga strukturat e kontrollit dhe auditimit në ISKSH. Për këtë, të nxirret një urdher nga titullari i institucionit për moskryerjen e pagesës, pa u bërë identifikimi i tyre.

Vazhdimisht

13. Të merren masa nga ISKSH, si institucion qendror për të vlerësuar mundësitë që ka në bashkëpunim me DRSKSH Tiranë dhe DRSKSH në QSUT, për të shmangur organizimin e prokurimit publik veçmas për blerje karburanti, por të zhvillohet në mënyrë të përqendruar në njërin institucion për (ISKSH, DRSKSH Tiranë dhe DRSKSH pranë QSUT) dhe në Drejtoritë e tjera Rajonale për organizimin në rang Qarku (Dibër, Korçë, Vlorë, Gjirokastrë, Elbasan etj).

Vazhdimisht

14. Për zbatimin e kontratave për kryerje rikonstruksioni të godinave të DRSKSH në rrethe, marrja në dorëzim e punimeve të bëhet me pjesëmarrjen detyruesisht të inxhinierit të ISKSH, si specialist direkt për fushën e ndërtimit.

Vazhdimisht

15. Të merren masa dhe të ndiqen në vazhdimësi zbatimi i tyre, për shpërblimin e dëmit dhe ato disiplinore, të kërkuara nga ISKSH për Qendrën Shëndetësore Rajçë, Librazhd. Për këto masa të iniciuara nga grupi i auditimit të KLSH, të njoftohemi zyrtarisht për zbatimin e tyre nga QSH dhe DRSKSH e Elbasanit.

Brenda muajit Shtator 2012

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Të merren masa dhe të ndiqen procedurat ligjore për shpërblimin e dëmit nga subjekti ■■■■■, në vlerën **369,952 lekë**, vlerë kjo e llogaritur më pak për penalitetet e llogaritura e vendosura për vonesat në furnizimin e mallit (libreza shëndeti), kjo në zbatim të nenit 10 të kontratës nr.5, datë 18.07.2011 ndërmjet ISKSH (blerësi) dhe ■■■■■

Brenda muajit Tetor 2012

2. Të merren masa nga ISKSH dhe DRSKSH Tiranë dhe të ndiqen procedurat ligjore për shpërblimin e dëmit nga subjekti ■■■■■ në vlerën **4,760 lekë**, për sa llogaritur e paguar tepër për shërbim roje.

Brenda muajit Shtator 2012

3. ISKSH, nëpërmjet Drejtorisë së Kontrollit Farmaceutik dhe Parësor, të marrë masa në bashkëpunim me DRSKSH Tiranë dhe të ushtrijë kontroll në farmacitë e konstatuara me shkelje ligjore nga ana e audituesve të KLSH, duke vepruar konform dispozitave ligjore në fuqi për **27 kontrata** me vlerë rimbursimi të kryer në shumën **44,545,657 lekë**. Të vlerësohen shkeljet e vendosur e arkëtuar në mënyrë ligjore gjobat e llogaritura në vlerë **270,000 lekë** që përbëjnë dëm ekonomik shtetit, pasi këto farmaci kanë kryer aktivitet tregtimi ilaçesh rimbursimi pa dokumentacion të rregullt ligjor në marrëdhënie me DRSKSH Tiranë, si dhe pa u plotësuar kriteret e vendosura në kontratë dhe Udhëzimin përkatës të Këshillit Administrativ.

Brenda muajit Tetor 2012

4. Të merren masa nga ISKSH(Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme dhe Drejtoria juridike) dhe të ndiqen procedurat ligjore për shpërblimin e dëmit nga subjekti ■■■■■ në vlerën **594,960 lekë**, për sekuestrim kontrate si pasojë e moszbatimit të kushteve të kontratës(kjo pasi sigurimi i kontratës është i vlefshëm deri në zbatimin e plotë të kontratës së operatorit ■■■■■).

Brenda muajit Shtator 2012

5. Të merren masa dhe të ndiqen procedurat ligjore për shpërblimin e dëmit nga 17 punonjësit që kanë përfituar padrejtësisht pagesa për udhëtim e dieta brenda vendit (dhe jashtë vendit 2 punonjëse 46 Euro x 140 lekë/euro) me dokumente të parregullta në vlerën 105,040 lekë.

Brenda muajit Tetor 2012

C. MASA DISIPLINORE

C. 1. *Mbështetur në nenin 37 e 171, të ligjit nr.7961, datë 12/7/1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” dhe Kontratën individuale të punës”, neni 9 germa “c”, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:*

“ Zgjidhje e kontratës së punësimit”, për:

1. **██████████ me detyrë Drejtor në Drejtorinë e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor në QSUT, për:**

- veprimet dhe mosveprimet e kryera si Drejtor i DRSKSH Tiranë (deri me datë 5/7/2011, periudhë kjo që ka konverguar me bërjen e kontratave F/2011 dhe shtesat e kontratave të trajtuara me mangësi e shkelje dhe që janë në 6 mujorin e parë dhe veçuar nga periudha tjetër).

- mos fillimin e procedurave për prishje të njëanshme të kontratës në referim të zbatimit të kushteve dhe kriterëve të vendosura në kontratat F/2011, duke lejuar e kryer rimbursimin e disa farmacive në kundërshtim me ligjin në vlera të konsiderueshme.

C. 2. *Mbështetur në nenin 37 e 171, të ligjit nr.7961, datë 12/7/1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” dhe Kontratën individuale të punës”, neni 9 germa “c”, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:*

“ Ulje në detyrë”, për:

1. **██████████ ish Shefe e Rimbursimit (periudha shtator-nëntor 2011) aktualisht Specialiste Finance, për:**

- moskryerje të detyrës dhe mosndjekje dhe kryerje kontrolli në farmacitë e konstatuara me shkelje ligjore, pasi ka patur për detyrë ndjekjen dhe zbatimin e kontratave me farmacitë dhe agjencitë e Tiranës për periudhën e drejtimit si përgjegjëse sektori),

- mos fillimin e procedurave për prishje të njëanshme të kontratës në referim të zbatimit të kushteve dhe kriterëve të vendosura në kontratat F/2011, duke lejuar e kryer rimbursimin e këtyre farmacive në kundërshtim me ligjin në vlera të konsiderueshme.

2. [REDACTED] *me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Shërbimeve në ISKSH*, për:
- mos kryerjen e detyrës në zbatimin e kontratës “Blerje shtypshkrime mjeku” për vitin 2011, kryerje e veprimeve të kundraligjshme në pranimin e mallit, si nënshkrimin e faturës tatimore pa ardhur malli, pa u kolauduar dhe pa u marrë në dorëzim nga komisioni i ngritur për këtë problem nga titullari i institucionit.

C. 3. Mbështetur në nenin 37 e neni 171, të ligjit nr.7961, datë 12/7/1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” dhe Kontratën individuale të punës”, neni 9 germa “a”, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Vërejtje”, për:

1. [REDACTED] *me detyrë Përgjegjëse Sektorit të Financës së Brendshme dhe Burimeve Njerëzore*, për:

- mos zbatimin drejt të Vendimeve të Këshillit Administrativ mbi trajnimet duke paguar punonjës, pa u plotësuar kushtet dhe nuk ka kërkuar ndryshimin e VKA dhe përshtatjen e trajnimeve me sistemin e Kartës së Bolonjës e mos përgatitjen e planit të trajnimeve me kërkesat e plota.

2. [REDACTED] *ish Shefe e Rimbursimit (deri me 5/9/2011), aktualisht Specialiste Finance ne ISKSH*, për:

- mos kryerje të detyrës dhe mosndjekje dhe kryerje kontrolli në farmacitë e konstatuara me shkelje ligjore, pasi ka patur për detyrë ndjekjen dhe zbatimin e kontratave me farmacitë dhe agjencitë e Tiranës për periudhën e drejtimit si përgjegjëse sektori),

- mos fillimin e procedurave për prishje të njëanshme të kontratës në referim të zbatimit të kushteve dhe kriterëve të vendosura në kontratat F/2011, duke lejuar e kryer rimbursimin e këtyre farmacive në kundërshtim me ligjin në vlera të konsiderueshme.

- shkelje ligjore të kryera në procedurat e prokurimit e vlerësimit të ofertave në tenderin për “Blerje karburanti” në DRSKSH Tiranë, për vitin 2011.

3. [REDACTED] *me detyrë Përgjigjës i Sektorit të Prokurimit*, për:

- mos përgatitje dokumentesh sipas kërkesave ligjore në fuqi në prokurimet për blerje me vlera të vogla të kryera në ISKSH gjatë vitit 2011.

4. [REDACTED] *me detyrë Zv/drejtor në DRSKSH Tiranë dhe*

5. [REDACTED] *me detyrë Specialist në DSKSH në QSUT*, për:

- shkelje ligjore të kryera në procedurat e prokurimit e vlerësimit të ofertave në tenderin për “Blerje karburanti” në DRSKSH Tiranë, për vitin 2011.

6. [REDACTED] *me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike*, për:

- mospërmbushjen e kushteve për furnizimin e mallit sipas kontratës nga kontraktuesi, me shoqërinë “E” sh.a. dhe mos sekuestrimin e sigurimit të kontratës pas kërkesës së bërë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore (Sektori i Financës), me shkresën nr. 230 prot, datë 27/10/2011.

- mos kryerje të veprimeve, për të detyruar në rrugë ligjore Shoqërinë e Sigurimeve “██████████” të kalojë shumën 594,960 lekë, në llogarinë e ISKSH-së, për mosplotësim të kushteve të kontratës.

7. ██████████ *Përgjegjëse e Sektorit Juridik dhe*

8. ██████████ *ish Specialiste në Sektorin Juridik, aktualisht punonjëse në Sektorin e Librezave, për:*

- mospërmbushje të detyrës së ngarkuar në hartimin dhe përgatitjen e kontratave me farmacitë për kontratat F/2011, sipas periudhës përkatëse që kanë qenë në detyrë dhe mos relativitetit për fillimin e procedurave për prishje të njëanshme të kontratës në referim të zbatimit të kushteve dhe kritereve të vendosura në kontratat, duke penguar rimbursimin e këtyre farmacive në kundërshtim me ligjin në vlera të konsiderueshme.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Bajram Lamaj Përgjegjës Grupi, Fadil Dekovi, Anila Halili dhe Monika Dushku. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit zj. Luljeta Nano, Drejtori i Departamentit z. Ded Trieshi dhe Juristi i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë z. Koço Sokoli (në mungesë të Drejtorit të Drejtorisë dhe me porosi), si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm z. Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT